

Papunësia

Të gjithë punonjësit janë të siguruar nga papunësia. Ata që mbeten të papunë zakonisht marrin ndihmë financiare për një periudhë të caktuar kohore. Të papunët duhet të regjistrohen në Qendrën Rajonale për Ndërmjetësim Punësimi (RAV). Kjo ju ndihmon kur kërkon punë.

Sigurimi i të papunëve

Sigurimi i të Papunëve (ALV) është një institucion shtetëror dhe është i detyrueshëm për të gjithë punonjësit. Kontributet mujore për të tërhiqen drejtpërdrejt nga paga, ndërsa punëdhënësi merr përsipër pjesën tjetër. Të pavarurit nuk mund të sigurohen në Sigurimin e Papunësisë. Kushdo që mbetet pa papunë, merr një mbështetje mujore si zëvendësim për pagën nga një arkë papunësie (Arbeitslosengeld). Nëse, kur dhe në çfarë shume do të paguhet të hollat për paunësinë, varet nga faktorë të ndryshëm. Për shembull, sa kohë keni punuar ose nga cilat arsye keni mbetur papunë.

Procedura në rast papunësie

Kushdo që mbetet papunë duhet sa më shpejt të lajmërohet në komunën ku banon. Do të ishte ideale që kjo të bëhet para ditës së fundit të punës, por jo më vonë se në ditën e parë të papunësisë. Në të njëjtën kohë duhet paraqitur në Qendrën përgjegjëse Rajonale të Ndërmjetësimit për Punësim (RAV). Të gjithë hapat e mëtejshëm shpjegohen atje.

Qendra Rajonale e Ndërmjetësimit për Punësim

Qendra Rajonale e Ndërmjetësimit për Punësim (RAV) ndihmon për të gjetur shpejt punë. Bisedat Këshilluese në RAV janë të detyrueshme nëse merrni pagesë për papunësinë. RAV-i gjithashtu ofron kurse ose programe punësimi. Poashtu disa prej tyre janë të detyrueshme. Edhe personat që nuk kanë punuar kurrë në Zvicër dhe janë në kërkim të një pune, mund të paraqiten në RAV, por ata nuk marrin para.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

dev.hallo-aargau.ch/sq/puna/papunesia